



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.4

Maj 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 16.4.2004.

PROJEKTLIGJE

Vendime për miratim të propozimit të projektligjit Kuvendit të Shqipërisë.

1. Për një shtesë në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut".

Shënim: Propozohet që në ligjin në fuqi, "Statusin e Dëshmorit të Atdheut" ta marin edhe ata persona që kanë dhënë jetën jashtë kufijve të vendit tonë, në luftën kundër terrorizmit.

2. Për një shtesë në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 "Për Agjensinë e Trajtimit të Kredisë", të ndryshuar.

Shënim: Me këtë shtesë rregullohet mënyra e zgjidhjeve të huave të marra nga ish-ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore.

3. Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989.

4. Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanise së Madhe dhe Irlandës së Veriut, për ripranimin e personave, dhe të protokollit të saj.

Vendime të Këshillit të Ministrave

1. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nënpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe

Kuvendit" dhe disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore" ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001, nr.158, datë 22.3.2001, nr.167, datë 30.3.2001, nr.174, datë 30.3.2001, nr.197, datë 6.4.2001, nr.358, datë 31.5.2001 dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave."

2. Për disa shtesa në vendimin nr.315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe trajnimit e nënpunësit civil."

3. Për miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2004.

4. Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për vendosjen e linjës ndërkombëtare liqenore për udhëtarë Shkodër-Vispazon.

5. Për një ndryshim në vendimin nr.300, datë 12.5.2001 të Këshillit të Ministrave, "Për pagesën e vlerës së trullit të shoqërive huamarrëse, për ndërtimin e apartamenteve për kreditorë, që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale".

6. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për shërbimin Informativ të Shtetit.

(Vijon në faqen 2)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave faqe 1-2

2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qendrore faqe 1

4. Nga punimet e Kuvendit për periudhën 16-30 prill 2004 faqe 3-4

5. Kalendar i 2 javor i Kuvendit, 26 prill - 6 maj 2004 faqe 5-6

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qendrore

Kuvendi i Shqipërisë
www.parlament.al

Këshilli i Ministrave
www.keshilliministrave.al

Presidenca
www.president.al

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme
www.mfa.gov.al

Ministria e Shëndetësisë
www.moh.gov.al

Ministria e Rendit Publik
www.mpo.gov.al

Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit
www.minek.gov.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

7. Për një shtesë në vendimin nr.363, datë 18.7.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve".
8. Për ndryshimin e përgjegjësive së administrimit të objekteve të ish-repartit të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (Kombinat), Berat, dhe të ish-repartit të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë 755 Elbasan, nga Ministria e Rendit Publik, Ministrisë së Drejtësisë.
9. Për ndryshimin e përgjegjësive së administrimit të mjediseve të katit të parë të degës së mobilizimit në Bilisht, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".
10. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Armo-sha-së.
11. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Albpetrol sha-së.
12. Për ndryshimin e përgjegjësive së administrimit të objektit të ish magazinave të ish-Qendrës Ekonomike të Arsimit, Sarandë, nga Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
13. Për miratimin në parim të marrëveshjes së paradhënies së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për përgatitjen e projektit të menaxhimit të burimeve ujore.
14. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.490, datë 16.10.2002 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bordit të kullimit të Rrethit Kavajë".
15. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e kullimit të Tiranës.
16. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Vlorës.
17. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Korçës.
18. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Shkodrës.
19. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Fierit.

20. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Durrësit.
21. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Lezhës.
22. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Krujë-Kurbini.
23. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Elbasanit.
24. Për miratimin në Parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Polonisë, për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar.
25. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim.
26. Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësllës-Kanalizimeve, në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, të përdorë procedurën "Prokurimi i drejtëpërdrejtë" për punimet e ndërtimit në hidrocentralin e Banjës.
27. Për fillimin e procedurës së dhënies me koncension të formës "BOO" dhe për përcaktimin e organit shtetëror të utorizuar për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncensionit për ndërtimin e impiantit për përpunimin e mbetjeve të ngurta urbane në Qarqet Tiranë-Durrës.
28. Për një shtesë fondi në buxhetin viti 2004, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për përballimin e shpenzimeve buxhetore, për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës me ekspertë, për reformën në fushën e drejtësisë, "Komisioni i Reformës Ligjore".
29. Për një shtesë fondi Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, për fazën e parë të informatizimit dhe shërbimit të gjendjes civile.
30. Për një shtesë fondi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit për përballimin e pagesës së asistencës teknike, për njësinë e menaxhimit të Projekteve të Transportit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve.
31. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor".
32. Për masën dhe kriteret për përfitim paafhtësie nga personat me statusin e Invalidit të Punës.

II. Mbledhja Këshillit të Ministrave e datës 23.4.2004

PROJEKTLIGJE

Vendime për miratim të propozimit të projektligjit Kuvendit të Shqipërisë.

1. Për disa ndryshime në ligjin nr.8770, datë 19.4.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike". Ky projektligji, bazuar edhe në praktikën e zbatimit të ligjit në fuqi; synon të krijojë lehtësira procedurale licensimi dhe mundësi investimi në shoqëritë që licensohen.
2. Për ratifikimin e marrëveshjes plotësuese, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të "Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut verior dhe shteteve të tjerë pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me statusin e forcave të tyre", mbi statusin e forcave të shteteve të bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë. Kjo marrëveshje shtesë e firmosur më 31 Mars 2004 në Tiranë nga Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, është përgatitur mbi bazën e Marrëveshjes së SOFA-s së NATO-s, e cila është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr.8034 datë 22.11.1995.
3. Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Italisë, për realizimin e programit "Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave". Ndërhyrja në 5 poliklinikat do të mbulojë një popullsi prej më shumë se 500 000 banorësh dhe do të ndikojë në uljen e fluksit të popullsisë drejt spitaleve, uljen e shpenzimeve spitalore për pacientët e jashtëm dhe rritjen e të ardhurave dytësore.
4. Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillimin (IDB) për financimin e fazës së dytë të projektit të spitalit të përgjithshëm, Durrës.

(Vijon në faqen 3)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

Vendime të Këshillit të Ministrave dt 23.4.2004

1. Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të industrisë joushqimore.
2. Për miratimin e strategjisë kombëtare të zhvillimit dhe të reformës institucionale në sektorin e pyjeve e të kullotave në Republikën e Shqipërisë.
3. Për miratimin e projektit pilot e të skemës së furnizimit më karburant pa akcizë dhe për përcaktimin e sasive të karburantit që do të përdoren për mekanikën bujqësore, në tre zona të vendit dhe për serat me ngrohje.
4. Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë.
5. Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore.
6. Për përballimin e shpenzimeve gjyqësore për zgjidhjen me marrëveshje pajtimi të procesit gjyqësor për çëshjten e pronësisë së 10 apartamenteve në Romë, Via Eritrea, nr. 34
7. Për miratimin e rregullores së disiplinës së gardës së Republikës së Shqipërisë.
8. Për miratimin e uniformës dhe shenjave të Policisë së Shtetit.
9. Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, në Babrru, Tiranë, Ministrisë së Rendit Publik, si dhe për organizimin e funksionimit të saj, dhe për një shtesë në numrin e parashikuar të punonjësve të kësaj ministrie.
10. Për transferimin në pronësi bashkisë së Ersekës të mjediseve të ish-brigadës së këmbësorisë dhe të degës së mobilizimit të cilat janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.
11. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Akademinë e Shkencave.
12. Për disa shtesa në vendimin nr.393, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pasurisë të paluajtëshme që prehen nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër –Vau i Dejes, pjesë e segmentit rrugor Lezhë – Shkodër.
13. Për shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2004-2005.
14. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
15. Për lejimin e institucioneve buxhetore të përdorin procedurën “Prokurimi i drejtëpërdrejtë”, për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të tyre motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.
16. Për lejimin e bashkisë së Durrësit të përdorë procedurën “Prokurimi i drejtëpërdrejtë”, për rikonstruktimin e segmentit rrugor turistik Ura e Dajlanit-Plepa në Durrës.
17. Për një ndryshim në vendimin nr 81, datë 6.2.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për shitje trualli Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë”.

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-30 PRILL 2004

1. Projektligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (miratuar në seancë plenare më datë 29 prill 2004).

Ky projektligj hedh një hap të rëndësishëm përpara për vendosjen e standardeve të kontabilitetit në të gjitha njësitë që kryejnë veprimtari ekonomike dhe për përgatitjen prej tyre të pasqyrave financiare, me synim përmirësimin e vendimmarrjes dhe uljen e shkallës së informalitetit në ekonomi. Ai parashikon zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për një kategori të sipërmarrjeve, si standarde të një cilësie të lartë, krahas standardeve kombëtare të kontabilitetit, të cilat synohet t'i përafrohen atyre ndërkombëtare.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe të Shoqatës së Kontabilistëve, të cilët shfaqën shfaqën mendimet e tyre për projektligjin. Përfaqësuesit e Shoqatës së Kontabilistëve e kundërshtuan projektligjin dhe kërkuan hartimin e një pakete të plotë ligjore në fushën e kontabilitetit, që të sigurojë formalizimin e tregut të mallrave dhe shërbimeve me bazë kontabilitetin, si dhe formalizimin e institucioneve të organizimit profesional të kontabilistëve dhe të revizorëve. Ata paraqitën disa vërejtje konkrete për projektligjin, veçanërisht për mënyrën e dokumentimit të veprimeve ekonomike, për mënyrën e krijimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, e cila sipas tyre, krijon konflikt interesash dhe për kompetencat e mëdha që i jepen këtij Këshilli, që çojnë në monopolizimin e tij. Ata u shprehën kundër zbatimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, të cilat sipas tyre, janë të parakohshme në vendin tonë, kur ende nuk është krijuar institucioni i Bursës, nuk ekziston tregu i kapitaleve dhe i letrave me vlerë dhe nuk janë krijuar ndërmarrje të mëdha me kapital të mjaftueshëm për të hyrë në Bursë.

Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit nuk ra dakord në parim me vërejtjet e përfaqësuesve të Shoqatës së Kontabilistëve, duke miratuar projektligjin e ardhur nga Këshilli i Ministrave, por ai mori në konsideratë një pjesë të vërejtjeve të tyre gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen.

Në diskutimin e tyre, deputetët e mbështetën projektligjin në parim, duke e vlerësuar veçanërisht për detyrimin që i ve ai njërive ekonomike që të mbështeten në standardet kombëtare të kontabilitetit dhe harmonizimin e tyre me standardet ndërkombëtare. Një nga çështjet kryesore që hapi debat kishte të bënte me nenin 4 të projektligjit, i cili i jep të drejtë Këshillit të Ministrave të miratojë me vendim standardet kombëtare të kontabilitetit. Për të rritur pavarësinë institucionale të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, deputetët vendosën ta ndryshojnë formulimin e këtij neni, duke ia dhënë kompetencën e shpalljes si të detyrueshme për zbatim të standardeve kombëtare të Kontabilitetit, Ministrinë të Financave. Lidhur me zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, për të cilat projektligji ngarkon me përgjegjësi Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, deputetët shprehën mendimin se detyrimin për shpalljen e zbatimit të tyre duhet ta ketë i njëjti institucion që vendos shpalljen e detyrimit për zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit. Për këtë arsye, ata vendosën që shpallja e detyrimit për zbatim si të standardeve kombëtare

(Vijon në faqen 4)

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-30 PRILL 2004

(Vijon nga faqja 3)

të kontabilitetit, ashtu edhe të atyre ndërkombëtare, të bëhet nga Ministri i Financave.

Një çështje tjetër që u diskutua, kishte të bënte me mungesën e sanksioneve në projektligj. Deputetët diskutuan disa variante të përgatitura nga specialistët për shtimin e një neni që përcakton sanksione për rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe theksuan se duhet të tentohet më tepër drejt vendosjes së dënimit administrativ dhe financiar se sa drejt vendosjes së dënimeve penale të ashpra, të cilat shpesh nuk zbatohen. Në përfundim, Kuvendi vendosi të shtojë një nen në projektligj, i cili për rastet e shkeljes së kërkesave të këtij ligji, i referohet masave ndëshkimore administrative, civile, ose penale të përcaktuara përkatësisht në dispozitat e Kodit Civil, Kodit Penal dhe ligjeve të tjera, në bazë të kërkesave të bëra nga palët e interesuara.

Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin, duke bërë edhe disa përmirësime të tjera në formulimin e disa neneve të tij.

2. Projektligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar (shqyrtuar në seancë plenare në muajin prill 2004)

Shqyrtimi i këtij projektligji në komisionet e përhershme të Kuvendit rifilloi pas një ndërprerjeje që nga muaji shtator 2003, për shkak të faturës së lartë financiare, e cila është e papërbalueshme nga Buxheti i Shtetit.

Projektligji është nismë e një grupi deputetësh të Partisë Demokratike dhe të disa partive të tjera opozitare. Ai ka për qëllim të realizojë kompensimin pasuror të ish-të dënuarve që kanë marrë pafajësinë nga gjykata, në mbështetje të ligjit përkatës dhe që gëzojnë statusin e ish-të dënuarit politik. Projektligji synon dhënien e dëmshpërblimit për çdo ditë burgu për ish-të dënuarit politikë që kanë marrë pafajësinë. Për personat që kanë humbur jetën ose janë të sëmurë psikikë, parashikohet dhënia trashëgimtarëve të tyre të ligjshëm e një shpërblimi të menjëhershëm në të holla. Gjithashtu, projektligji synon që letrat e privatizimit, të mbetura në duart e ish të dënuarve e të përndjekurve politikë, të kthehen në lekë brenda një periudhe 3-vjeçare.

Për të bërë të realizueshëm projektligjin, nismëtarët e tij paraqitën edhe disa amedamente shtesë, në të cilat ndër të tjera, parashikohet që dhënia e dëmshpërblimit të fillojë në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit dhe të zgjasë për një periudhë tetëvjeçare, duke e ndarë masën e dëmshpërblimit për çdo vit, në përputhje me rritjen e Buxhetit të Shtetit. Po për këtë qëllim, ata propozuan shkallëzimin e dëmshpërblimit sipas moshës ose gjëndjes shëndetësore. Gjithashtu, ata propozuan që dhënia e dëmshpërblimit, krahas pagesës në lekë, të bëhet edhe në mënyra të tjera si psh nëpërmjet dhënies së një përqindjeje nga privatizimi i ndërmarrjeve strategjike etj.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit deputetët e maxhorancës kërkuan shtyrjen e shqyrtimit të tij në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, për të kërkuar ndërkohë mendimin e specializuar të Komisionit të Venecias, ashtu siç është vepruar edhe me ligjin “Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Përfaqësuesit e Qeverisë shprehën mendimin se duhet hartuar një kuadër i plotë ligjor për ish-të përndjekurit poli-

tikë, i cili të përcaktojë qartë se cilat shtresa sociale do të përfitojnë.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan këtë mendim të deputetëve të maxhorancës, duke theksuar se projektligji ka dy vjet që është paraqitur për shqyrtim në Kuvend dhe ka patur kohë të mjaftueshme për të marrë mendimin e institucioneve të specializuara. Sipas tyre, Komisioni i Venecias e ka dhënë ndihmesën e tij në hartimin e Kushtetutës dhe të Kodeve, në të cilat përcaktohet qartë se çdo person që është dënuar pa të drejtë dhe ka marrë pafajësinë nga gjykata, duhet të dëmshpërblehet. Ata u shprehën kundër shtyrjes së shqyrtimit të projektligjit.

Në përfundim, Kuvendi miratoi me shumicë votash mendimin e deputetëve të maxhorancës për heqjen nga kalendari i punimeve të këtij projektligji dhe shtyrjen e shqyrtimit të tij.

3. Projektvendimi “Për shfuqizimin e tarifave të telefonisë fikse dhe të çmimeve të energjisë elektrike” (miratuar në seancë plenare më datë 29 prill 2004)

Projektvendimi është nismë e një grupi deputetësh të Partisë Demokratike dhe synon shfuqizimin e tarifave të telefonisë fikse dhe të çmimeve të energjisë elektrike, rritja e të cilave kohët e fundit ka ngritur koston e jetesës së shtetasve shqiptarë.

Gjatë shqyrtimit të projektvendimit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, deputetët e opozitës theksuan se rritja e çmimeve të telefonisë fikse dhe të energjisë elektrike nuk është pjesë reformash, ajo nuk reflekton zhvillimet në ndonjë sektor të ekonomisë dhe nuk është shoqëruar me masa lehtësuese nga ana e shtetit shqiptar. Kjo rritje, sipas tyre, bëhet mekanikisht, për të mbuluar koston e prodhimit dhe synon të mbulojë humbjet që i vijnë shtetit shqiptar nga mospagimi i detyrimeve nga një pjesë e debitorëve. Deputetët e maxhorancës e kundërshtuan projektvendimin, i cili sipas tyre, vjen në kundërshtim me ligjin nr.8288, datë 18.2.1998 “Për entin rregullator të telekomunikacioneve” dhe me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Ata spjeguan se ligjet e sipërcituara ngarkojnë përkatësisht Entin Rregullator të Telekomunikacioneve të miratojë tarifat e telekomunikacioneve dhe Entin Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike të përcaktojë tarifat e shitjes së energjisë elektrike, të cilat propozohen nga i licencuari. Të dyja këto institucione janë të pavarura nga Këshilli i Ministrave. Pra, sipas tyre, Kuvendi nuk mund të ushtrojë kompetencat e dy enteve të pavarura, të krijuara prej tij me kompetenca të plota ligjore në fushat përkatëse. Ata theksuan se rritja e çmimeve është pjesë e reformës që po ndërmerret në këta dy sektorë, ku qëllimi i liberalizimit të çmimeve është zgjerimi i tregut me operatorë të tjerë dhe kostoja sociale që vjen si pasojë duhet marrë parasysh në funksion të këtij qëllimi.

Me këto argumente, Kuvendi miratoi heqjen e projektvendimit nga kalendari i punimeve të tij.

KALENDAR I

2 JAVOR (26 PRILL - 6 MAJ 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

E Hënë, datë 26.04.2004, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.
2. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Shtetit për Koordinim.
3. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Jashtëm.
4. Raport i Qeverisë për Shërbimin Civil 2003.

- Pyetje dhe diskutime.

E Martë, datë 27.04.2004

E Mërkurë, datë 28.04.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. Diskutimi dhe shqyrtimi i konkluzioneve të Raportit të Komisionit European të vitit 2004 mbi procesin e Stabilizim-Asocimit”.

-Të gjitha komisionet

2. P/Ligji “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Rendit

3. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së konçensionit, të Formës “BOO”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e Terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj, në Gjirin e Vlorës, si dhe për ratifikimin e marrëveshjes së konçensionit të Formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar, në Gjirin e Vlorës”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

-Komisioni i Industrisë

-Komisioni i Shëndetësisë dhe

Mjedisit

4. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8353, datë 3.6.1998 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë,

ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin e Autostradës Vorë-Durrës”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Industrisë

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

5. P/Ligji “Për industrinë jo ushqimore”.

-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Industrisë (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

6. P/Ligji “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Industrisë (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

7. P/Ligji “Dekret nr. 4181, datë 23.03.2004 “Kthimi për shqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr. 9198, datë 26.02.2004 “Për një shoqëri gjinore të barabartë”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i të Drejtave të Njeriut

8. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit” (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale

-Komisioni i të Drejtave të Njeriut

9. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

10. P/Ligji “Për punën e Kuvendit në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin European”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Rendit

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

-Komisioni i Bujqësisë dhe

Ushqimit

-Komisionet e tjera

11. P/Ligji “Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës”.

-Rakordimi i vërejtjeve në

Komisionin e Bujqësisë dhe

Ushqimit

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

E Enjte, datë 29.04.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare -

1. P/Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”.
2. P/Ligji “Për industrinë jo ushqimore”.
3. P/Ligji “Për shërbimin meteorologjik ushtarak”.
4. P/Vendim “Për shfuqizimin e tarifave të telefonisë fikse dhe të çmimeve të energjisë elektrike”.

Për Votim:

1. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe udhëtarëve”.
2. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Infrastrukturës Ujore, Bashkiake”.
3. P/Ligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9118, datë 24.7.2003 “Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të papaguara”.

(Vijon në faqen 6)

Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 5)

4. P/Ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
5. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për Gjendjen Civile”.

E Hënë, datë 3.05.2004, ora 18.00
-Seancë Plenare -

1. Mocion për debat lidhur me Raportin e Komisionit Europian të vitit 2004 mbi Procesin e Stabilizim Asociimit.

E Martë, datë 4.05.2004

E Mërkurë, datë 5.05.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit (e ka shqyrtuar)

2. P/Ligji “Për kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për organizimin e ndarjes Administrativo-Territoriale të Republikës së Shqipërisë”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

3. P/Ligji “Për miratimin e Kodit Detar Shqiptar”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Mbrojtjes

-Komisioni i Industrisë dhe

Telekomunikacionit

-Komisioni i Shëndetësisë dhe Mjedisit

4. P/Ligji “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit

-Komisioni i Shëndetësisë dhe Mjedisit

5. P/Ligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Industrisë

6. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga sistemi komunist” të ndryshuar me ligjin nr. 7771, datë 7.12.1993” (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale

-Komisioni i të Drejtave të Njeriut

E Enjte, datë 6.05.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare -

1. P/Ligji “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit”.

2. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncensionit, të Formës “BOO”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e Terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj, në Gjirin e Vlorës, si dhe për ratifikimin e marrëveshjes së koncensionit të Formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar, në Gjirin e Vlorës”.

3. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8353, datë 3.6.1998 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin e Autostradës Vorë-Durrës”.

4. P/Ligji “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

5. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit” (paraqitur nga një grup deputetësh).

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj,
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”. Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar të krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare “QSP” në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

“Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.

Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP.”

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasherit, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; cps@albaniaonline.net;
www.ascpdp.org